

Seance Plenare
Jul

KUVENDI
NR. 1609 DATE 25.04.24



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

Lënda: Propozohet për shqyrtim dhe miratim një projektligj.

Drejtuar: Znj. Lindita NIKOLLA
Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë

Znj. Kryetare e Kuvendit,

Në mbështetje të nenit 81, pikat 1 dhe 2 të Kushtetutës dhe nenit 68, pika 1 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, bashkëlidhur gjeni për shqyrtim dhe miratim projektligjin “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, shoqëruar me relacionin përkatës, të propozuar nga një deputet i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

Ju lutem, marrjen e masave për nisjen e procedurave parlamentare për shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektligji në Kuvendin e Shqipërisë, në përputhje me nenet 68 e vijues të Rregullores.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

KRYETARI

Lulzim Basha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ
Nr. ____/2024

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN 95/2016,
“PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONEVE
PËR TË LUFTUAR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR”,

Në mbështetje të neneve 81, pika 2 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, bëhen shtesat dhe ndryshimet, me përmbajtje si më poshtë vijon:

Neni 1

Në pikën 1 të nenit 17 pas gërmës e) shtohet gërma ë) me këtë përmbajtje:
“ë) Sektori i Ndhmës Ligjore”

Neni 2

Në nenin 12 pika 4 ndryshohet si vijon:

“4. Në përfundim të mandatit të prokurorit të posaçëm, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, brenda tre muajve, e emëron atë pa konkurim në Prokurorinë e Përgjithshme, në prokurorinë e Apelit, ose me kërkesë të prokurorit në pozicionin e drejtuesit të prokurorisë së rrethit. Prokurori i posaçëm ruan të njëjtin nivel page edhe pas përfundimit të mandatit”.

Neni 3

Pas nenit 25 shtohet neni 25/1 me këtë përmbajtje:

Neni 25/1
Sektor i Ndhmës Ligjore

- Sektor i ndihmës ligjore ushtron veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në hetimet e Prokurorisë së Posaçme duke përfshirë:
 - përgatitjen e projektakteve, realizimin e kërkimeve ligjore, analizimin e praktikës hetimore përkatëse dhe interpretimin e dispozitave të zbatueshme për çështjet në hetim;
 - përmbledhjen e procedurës hetimore;

- c) kryerjen e detyrave të tjera për përpunimin e çështjes siç kërkohet nga prokurori kompetent.
2. Drejtuesi i Prokurorisë për çdo hetim cakton një punonjës të Sektorit të Ndihmës Ligjore, duke marrë parasysh përvojën profesionale dhe specializimin e tyre, si dhe duke siguruar ngarkesë pune të barabartë ndërmjet tyre.
 3. Punonjësit e këtij sektori duhet të kenë diplomë masteri të nivelit të dytë në drejtësi ose arsim të lartë juridik të njësuar me të sipas ligjit për arsimin e lartë.
 4. Punonjësit duhet të ketë të paktën pesë vite përvojë në fushën e drejtësisë ose në administratën publike.

Neni 4

Fondi i pagave për pagave për Sektorin e Ndihmës Ligjore, për vitin 2024 përballohet nga buxheti i Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

Neni 5

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare

K R Y E T A R J A

Lindita NIKOLLA